

Lista e institucioneve publike, 2020

Tiranë, më 14 Shtator 2021: INSTAT, ofron për përdoruesin listën e institucioneve publike, pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme si dhe ndërmarrjet Financiare dhe Jo-financiare që janë në pronësi të entiteteve publike për vitin 2020.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik \(link\)](#)

Njësitë shpenzuese buxhetore të Sektorit Publik përbëhen nga: nën-sektori i Qeverisë Qendrore (S.1311) me 896 njësi shpenzuese buxhetore, nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 194 njësi shpenzuese buxhetore dhe nën-sektori Fondet e Sigurimeve (S.1314) me 2 njësi shpenzuese.

Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese buxhetore ndër vite vjen si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të Qeverisë, riklasifikimeve, si dhe njësive të reja apo të mbyllura.

Tab. 1 Sektori Publik në Shqipëri, Viti 2020

| Klasifikimi sipas nën-sektorëve | | Viti 2020 |
|------------------------------------|---------|--------------|
| Qeveria Qendrore | S.1311 | 954 |
| <i>Buxhetore</i> ¹ | | 896 |
| <i>Extra-Buxhetore</i> | | 58 |
| Qeveria Federale ² | S.1312 | - |
| Qeveria Lokale | S.1313 | 303 |
| <i>Buxhetore</i> | | 194 |
| <i>Extra-Buxhetore</i> | | 109 |
| Fondet e Sigurimeve | S.1314 | 2 |
| Ndërmarrjet Publike Jo-financiare | S.11001 | 26 |
| Ndërmarrjet Publike Financiare | S.12 | 2 |
| Banka Qendrore | S.121 | 1 |
| Totali i Njësive Shpenzuese | | 1.288 |

Njësitë extra-buxhetore të Sektorit Publik përbëhen nga nën-sektori i Qeverisë Qendrore (S.1311) me 58 njësi shpenzuese dhe nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 109 njësi shpenzuese.

Përveç institucioneve buxhetore dhe extra-buxhetore, sektori publik, përfshin edhe nën-sektorin e ndërmarrjeve Publike Jo-financiare (S.11001) me 26 njësi, nën-sektorin e ndërmarrjeve Publike Financiare (S.12) me 2 njësi dhe nën-sektorin e Bankës Qendrore (S.121) me 1 njësi.

¹ Numri i Njësive Shpenzuese buxhetore përbëhet nga njësitë aktive shpenzuese që raportohen në sistemin e thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2020.

² S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri.